

## RELACION

### PËR PROJEKTVENDIMIN E KËSHILLIT TE MINISTRAVE

#### PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE, PROCEDURAVE DHE KRITEREVE TË OFRIMIT TË SHËRBIMEVE TË VENDIMMARJES SË MBËSHTETUR PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR”

#### I. QËLLIMI I PROJEKT AKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektvendimi është në përputhje me pikën 3, të nenit 7 të Ligjit Nr. 93/2014 “Për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara”.

Objektivi kryesor që synohet të arrihet është të reflektohen parimet e Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar. Konkretisht, Neni 12 i KDPAK trajton të drejtën për barazi para ligjit dhe çështjen e aftësisë juridike, që është njohja nga ligji e vendimeve që merr një person.

Vendimarrja e mbështetur në këtë projekt-vendim nuk zëvendëson regjimet aktuale të kujdestarisë apo përfaqësimit ligjor. Projektvendimi synon të sjellë disa kompetenca të shtuara, në zbatim të Ligjit Nr. 93/2014 dhe rregulla për të nxitur marrjen e vendimeve nga PAK në bashkëveprim me mbështetësin e tyre në marrjen e disa vendimeve për jetesën e përditshme. Miratimi i këtij vendimi është një masë për realizimin e vendimarrjes së mbështetur, si një alternativë për marrjen e vendimeve nga personat me aftësi të kufizuar.

Vendimarrja e mbështetur sipas nevojës është një masë pozitive që personi me aftësi të kufizuar të jetë mbajtës i të drejtave dhe jo thjesht përfitues i mbrojtjes sociale apo rehabilitimit.

#### II. VLERËSIMI I PROJEKT VENDIMIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky akt është në përputhje me programin politik të Këshillit të Ministrave, Kapitulli Mirëqenie për të Gjithë dhe hartohet brenda programit analitik të akteve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për tremujorin e tretë të vitit 2022.

#### III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Miratimi i këtij Projekt-vendimi do të mundësojë ofrimin e mbështetjes për vendimarrje për Personat me Aftësi të Kufizuar, si një alternativë për fuqizimin, pavarësinë dhe autominë e tyre. Mbështetja jepet gradualisht, duke u dhënë kohë të mjaftueshme personave që e kërkojnë atë, për të mësuar se si mund ta përdorin mbështetjen për më të mirën e tyre.

Në zbatim të parimit të realizimit progresiv të Ligjit Nr.93/2014 "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara", shërbimet e vendimmarrjes së mbështetur që ofrohen për personat me aftësi të kufizuar bazohen në kritere të vecanta sipas Kreut II të PVKM dhe mbulojnë (a) marrjen e vendimeve për shërbimet e nevojshme sociale, terapeutike e shëndetësore; (b) të formimit profesional e punësimit; (c) të marrëdhënieve me ndihmësin personal; (d) të vendbanimit, (dh) të marrëdhënieve ndërpersonale

#### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Ky projektvendim hartohet në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës është në përputhje me kërkesën e pikës 3, të nenit 7 i Ligjit Nr. 93/2014 për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe me parimet e Konventës së OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.

#### **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS TË BASHKIMIT EVROPIAN (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)**

Projektvendimi nuk synon përputhshmëri me *Acquis* të Bashkimit Evropian.

#### **VI. PËRMbledhje shpjeguese e PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT**

Projekt-vendimi përmban rregullat kryesore për vendimmarrjen e mbështetur, si një proces që rrit mundësitë që PAK të marrin vendime me ndihmë ose mbështetje për vendimmarrje. Kjo mbështetje ofrohet në mënyrë të atillë që të reduktojë kufizimin e të drejtave dhe lirisë së personit i cili mbështetet duke respektuar dinjitetin, integritetin, privatësinë, pavarësinë. Vendimmarrja e mbështetur është proporcionale me atë çfarë kërkohet dhe përshtatet gradualisht. Gjithashtu, ndihma synon të lejojë, inkurajojë dhe ndërmjetësojë pjesëmarrjen e personit dhe të përmirësojë aftësitë e personit për të marrë vendime ose për të marrë pjesë në vendimmarrje.

Personi nuk do të konsiderohet si paafte për të marrë vendime bazuar vetëm mbi faktin se vendimet e tij mund të mos pranohen nga mbështetësi i tij. Mungesa e aftësisë për të marrë një vendim në një fushë të caktuar nuk nënkupton mungesën e aftësisë për të marrë vendime në fusha të tjera. Rregullat janë në përputhje me praktikat ndërkombëtare dhe sqarimet e Komitetit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara për vendimmarrjen e mbështetur.

Përsa u përket kritereve të zgjedhjes së ndihmësve në vendimmarrje, ata janë individë ose grupe individësh që kanë zhvilluar një marrëdhënie besimi me vendimmarrësin dhe janë zgjedhur prej tij të tillë si ndihmës personalë, shokë e shoqë; anëtarë të familjes; persona juridike që kryejnë funksione avokatie të personave me aftësi të kufizuar; persona të punësuar në qendra shërbimesh, qendra rezidenciale apo në komunitet; administratorë shoqërorë që kryejnë funksionet e koordinatorit të mbështetjes ose një punonjës nga strukturat përgjegjëse për shërbimet e kujdesit shoqëror pranë bashkive dhe njësive të vlerësimit të nevojave dhe referimit. Për shkak të karakterit të marrëdhënies që ka mes mbështetësit dhe personit, është e nevojshme që kjo marrëdhënie të jetë zhvilluar në besim.

Mbështetësi, sipas kërkesës së ligjit, kërkohet që të përcjellë dëshirat dhe preferencat e personit, të mbrojë interesat e tij.

Mbështetësi duhet të plotësojë këto kushte a) Mbështetësi dhe personi që mbështetet nga ai kanë një lidhje afatgjatë; b) Mbështetësi ka aftësinë për të përçuar vendimet, dëshirat dhe preferencat e personit që mbështet; c) Mbështetësi është i gatshëm që të mbështesë në vendimmarrje personin që kërkon këtë mbështetje, të veprojë në interesin e personit duke mbajtur në vëmendje dëshirat dhe preferencat e personit. Gjithashtu ata nuk kanë konflikt interesi me personin që i ofrojnë shërbimin për çështjet që ofrojnë ndihmën. dhe nuk janë dënuar me vendim gjykate, të formës së prerë, për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje dhe nuk kanë vendim gjykate me një nga masat mbrojtëse ndaj dhunës në familje

Për shkak të natyrës që ka mbështetja në vendimmarrje parashikohet që mbështetësit për vendimmarrje bien dakord të ofrojnë këto shërbim kur është e nevojshme sipas kërkesës së personit me aftësi të kufizuara. Kjo shprehet edhe në deklaratën që bën personi me aftësi të kufizuara dhe mbështetësi, një model i së cilës është vendosur në Aneks 1.

Vendimi parashikon sa herë që është e mundur, mbështetësit në vendimmarrje janë së paku dy persona të deklaruar si të tillë që bashkëpunojnë për procesin e mbështetjes, në mënyrë që të krijohet një grup mbështetës në vendimmarrje, i cili siguron balancat e nevojshme dhe një vendimmarrje në një proces më të sigurtë dhe gjithëpërfshirës.

Informacioni i mbështetësve të zgjedhur nga vendimmarrësit duhet të vihet në dosjen përkatëse të personit në qendrat e shërbimeve, në qendrat e kujdesit rezidencial si edhe në sektorin social të bashkisë përkatëse.

Procedura e vendimmarrjes së mbështetur midis mbështetësve dhe institucioneve publike dhe jopublike synon që personat me aftësi të kufizuara të lehtësohen në procesin e vendimmarrjes përmes masave të ndryshme që ata ndërmarrin. Këto masa mund të jenë: (a) mbledhja e informacionit të nevojshëm për të marrë një vendim dhe modifikimi i tij për t'u bërë i kuptueshëm në formatin më të përshtatshëm për personin që merr vendimin, (b) prania në procesin e vendimmarrjes, c) sqarimi i alternativave në një gjuhë të kuptueshme për vendimmarrësin, dhe (d) shpjegimi i vendimeve të vendimmarrësit.

Gjithashtu parashikohet përgatitja për vendimmarrje të mbështetur, ku parashikohet përgatitja e personave që janë në institucione, qendra ditore dhe rezidenciale, stafi i të cilave është përgjegjës për përgatitjen e personave për vendimmarrje dhe përgatitja e personave që nuk banojnë në këto institucione, përgatitja e të cilëve realizohet nga Bashkitë, koordinuar nga MSHMS.

Në dispozitat e fundit parashikohet që vendimi zbatohet për sa kohë nuk bie në kundërshtim me akte të tjera ligjore e nënligjore në fuqi në lidhje me heqjen e zotësisë për të vepruar, kujdestarisë ligjore dhe rregullave të përfaqësimit. Kjo për arsyet e përmendura më lart. Në rast se parashikimet e përcaktuara në këtë vendim bien në kundërshtim me akte ligjore dhe nënligjore të tjera, do të zbatohet parimi i hierarkisë së normave.

Efekti i pritshëm i këtij projekt- vendimi është rregullimi dhe përmirësimi i vendimmarrjes dhe pjesëmarrjes efektive të personave me aftësi të kufizuara, rritja e vetëbesimit dhe njohja e preferencave dhe dëshirave të personave me aftësi të kufizuara.

## **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT**

Ngarkohen të gjitha organet e administratës shtetërore sociale dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

## **VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKT-AKTIT**

Ky projektvendim është hartuar nga një grup pune dhe ekspertë të fushës, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe dërgohet për konsultim të brendshëm në Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Ministrinë e Kulturës, Ministrinë e Brendshme, Ministria e Transportit dhe Energjetikës dhe Këshillin Konsultativ të Vetëqeverisjes Qendrore dhe Vendore.


## **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi do të përballohen nga buxheti i institucioneve përgjegjëse sipas fushës së tyre të përgjegjësisë.

### **PROPOZUESI**

**OGERTA MANASTIRLIU**

**MINISTER**



---

Relacion shpjegues për projektvendimin e Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e rregullave, procedurave dhe kritereve të ofrimit të shërbimeve të vendimmarjes së mbështetur për personat me aftësi të kufizuar"